

Ta njohësh gjykatën tënde

Organizimi dhe struktura e gjykatës
Gjykata e Qarkut në Prishtinës përbëhet nga Kryetari i Gjykatës, 14 gjyqtarë dhe 50 punonjës administrativë.

Kryetari i Gjykatës	Isak Ademi
Gjyqtarët në lëmin penal	Gjyqtarët në lëmin civil
Tonka Berisha Mejdi Dehari Hamdi Ibrahim Hajrije Shala Rafet Haxha Vehbi Kashtanjeva Thëllanza Kadiu Shqipe Qerimi Mejreme Mema	Nehat Idrizi Gëzim Llullani Mediha Jusufi Shemsi Hajdini Salih Toplica
Administrata	
Administrator Arkëtar	Feriz Berisha Enver Zhitija

Orari i punës në gjykatë

Puna në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë fillon në 8:00 deri në ora 16:00, çdo ditë pune nga e hëna deri të premtën, me një pushim dreke nga ora 12:00 deri në ora 13:00. Gjykata nuk punon vikendeve dhe ditëve të festave, bazuar në orarin e festave shtetërore të caktuara nga Qeveria e Kosovës. Mirëpo përkundër kësaj, në gjykatë funksionon kujdestaria 24 orë çdo ditë të javës. Mbarëvajtjen e punës në kujdestari e bënë gjyqtari i procedurës paraprake, nën mbikëqyrjen e Kryetarit. Ndërsa ndërtesa sigurohet nga punëtorët e sigurimit, nën mbikëqyrjen e Administratorit të gjykatës.

Oraret e seancave në gjykatë

Oraret e seancave për secilin gjyqtar gjenden të publikuara në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Seancat janë të hapura, përveç rasteve të caktuara më ligj si të mbyllura për publikun. Seancat mbahen në sallën e gjykimeve, në mungesë të sallës seancat mbahen edhe në zyrat e gjyqtarëve. Gjykata ka dy salla gjykimi dhe dy kabinete me nga 20-40 vende.

Administrata në gjykatë

Administrata në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ndër të tjera, kryen edhe këto shërbime: menaxhimin e lëndëve, shërbimet gjyqësore të natyrës administrative, shërbimet për komunikim me publikun, arkivimin dhe shërbimet financiare/arka.

1. Zyra Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve

Në Zyrën Qendrore të gjykatës pranohen parashtrës, dokumentet dhe aktet procedurale. Zyra Qendrore mbanë regjistrat ku regjistrohen lëndët në lëmin penal, civil dhe kategoritë tjera të lëndëve. Zyra Qendrore po ashtu shpërndan shkresat e lëndëve. Dhe në fund, pas përfundimit të gjykimit merr në dorëzim shkresat e lëndëve dhe bën arkivimin e tyre.

2. Shërbimet gjyqësore të natyrës administrative

Gjykata kryen edhe shërbime gjyqësore të natyrës administrative si: njohjen e vendimeve të huaja, mundësinë e shikimit dhe kopjimit të shkresave të lëndës, nxjerrjen e lëndës nga arkivi si dhe veprimet tjera në lëmin penal dhe civil.

3. Komunikimi me publikun

Në gjykatë ju mund të kërkonit informacionet që ju nevojiten. Informacionet do t'ju jepen në recepcion ose do t'ju drejtojnë për në zyrën përkatëse. Po ashtu, ju mund të kërkonit të takoheni me kryetarin e gjykatës sipas kërkesës. Kërkesa për të takuar kryetarin e gjykatës duhet të bëhet me shkrim. Formulari mund të merret dhe të dorëzohet në gjykatë. Për informacione, njoftime dhe kërkesa tjera, ju mund t'i drejtoheni recepcionit.

4. Arkiva

Arkiva e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë përmban lëndë të arkivuara që nga viti 1980. Lëndët e arkivuara janë publike, nën kushte të caktuara. Këto lëndë mund të shikohen me një kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës. Formulari mund të merret dhe të dorëzohet në gjykatë.

5. Shërbimet financiare/arka

Gjykata kryen edhe shërbime financiare për palët. Ju mund t'i paguani taksat gjyqësore për çdo lloj parashtrëse në gjykatë. Taksat gjyqësore janë të caktuara sipas Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore Nr.2008/02. Taksat deri në 5 euro paguhen në gjykatë, ndërsa shumat më të mëdha paguhen në bankë. Urdhërpagesa për të bërë pagesën në bankë merret në gjykatë.

Juridiksioni i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

Juridiksioni i gjykatës së qarkut është përcaktuar sipas Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta të vitit 1978.

Për cilat komuna është kompetente Gjykata e Qarkut në Prishtinë?

Është kompetente për territorin e komunës së Prishtinës, Lipjanit, Ferizajt, Drenasit, Podujevës, Obiliqit, Graçanicës, Shtimes, Shtërpçës, Fushë Kosovës dhe Kaçanikut.

Për cilat lëndë ka juridiksion Gjykata e Qarkut në Prishtinë?

Gjykata e Qarkut në Prishtinë shqyrton lëndë civile dhe penale më të rënda, dhe gjithashtu shërben si gjykatë e shkallës së dytë për lëndët me të cilat janë marrë gjykatat komunale të cilat janë nën juridiksionin e saj territorial.

Sidomos:

- Shqyrton lëndë civile duke përfshirë shkurorëzimin, vërtetimin dhe kundërshtimin e amësisë dhe atësisë, etj.
- Shqyrton ato lëndë penale për të cilat parashihet dënimi me burgim më shumë se pesë vite, si vrasja, dhunimi, trafikimi, grabitja, vjedhja e rëndë, etj.
- Shqyrton në shkallë të dytë ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë nga Gjykata Komunale në Prishtinë, Lipjan, Ferizaj, Drenas, Podujevë dhe Kaçanik..

Qëllimi i kësaj broshure

Kjo broshurë është përpiluar nga Programi i Gjykatave Model, e mbështetur nga USAID-Programi për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë. Kjo broshurë paraqet informacione të rëndësishme dhe të nevojshme lidhur me Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Numrat e telefonave në gjykatë

Centrali telefonik
038 248 908

Faksi
038 247 008

Ligji i ri për gjykatat është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në korrik 2010. Ky ligj do të hyjë në fuqi me 01.01.2013. Ligji mund të gjendet në ueb faqën e Kuvendit të Republikës së Kosovës:
www.assembly-kosova.org



TA NJOHËSH GJYKATËN TËNDE



Gjykata e Qarkut në Prishtinë